



Prishtinë: 30.09.2011

Kodi i ZRRE-së: V_374_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_609_06_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_609_06_11**;
5. Apelimi i konsumatorit me datë 08.07.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Ramadan Aliu (shifra e konsumatorit DPR – 2005219) nga Fushë Kosova, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 20.07.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 23.06.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 23.10.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë hasur në kyçje ilegale jashtë njehsorit elektrik nga konsumatori Ramadan Aliu dhe kanë regjistruar të dhënat teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 170914 të datës 23.10.2008
- Me datë 26.11.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP07078 në vlerë prej 587.85 €.
Provë: Fatura DPR08HP07078 e datës 26.11.2008
- Me datë 15.12.2008 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare pranë organeve të KEK-ut për lidhje të re.
Provë: Kërkesa e konsumatorit për lidhje të re e datës 15.12.2008
- Me datë 04.03.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë pranimin teknik të instalimit elektrik për njehsorin elektrik nr. 44934293.
Provë: Procesi për pranimin e instalimit elektrik nr. 026230 i datës 04.03.2009
- Me datë 14.07.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë bërë ri vulosjen e njehsorit me vulë distributive nr. 10064570.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 317828 të datës 14.07.2009
- Me datë 26.11.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK



- Me datë 23.06.2010 Departamenti për Konsumatorë në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalet e kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 23.06.2010
- Me datë 20.07.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 17.06.2011 DMK ka lëshuar një vendim duke refuzuar pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të:
 1. Shkarkojë konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP07078 e datës 26.11.2008 në vlerë 587.85 €.
 2. Rikalkulojë faturën e rikthimit të humbjeve duke marrë për bazë mesataren e shpenzimit të njehsorit elektrik nr. 44934293 prej periudhës 04/2009 – 03/2010 e cila është 520 kWh/muaj dhe vetëm tre muaj ashtu siç është përcaktuar në procesin e kontrollës së KEK-ut nr. 170914 të datës 23.10.2008.
- Me datë 08.07.2011 konsumatori ka apeluar vendimin e DMK në Bordin e ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit drejtuar Bordit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_609_06_11** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: **ZRRE/DMK_V_609_06_11** të mbetet në fuqi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar